



Zofingen, 17.5.2014

Mledhje e rregullt e Shoqates Humanitare „Jerina“

Ne Zofingen të Zvicres u mbajt mbledhja e rregullt e Shoqates Humanitare „Jerina“ e cila i bashkon bashkëvendasit tonë që jetojnë e punojn në Zvicër.

Muren Pjesë:

Bajram Mehmeti - Kryetarë

Asllan Salihu

Islam Sadiki

Lulzim Avdyli

Sami Himaj

Arben Himaj

Nehat Botusha

Enver Alija

Ramë Batusha

Fahri Alija

Muhamet Botusha

Adnan Avdyli

Naim Zajmi

Sejd Musa

Tahir Nimoni

Arbit Avdyli

Fahri Avdyli

Baton Halilaj
Tahir Mehmeti
Bedrush Mehmeti

Mbledhja filloi me këtë Rend dite:

- 1. Raporti i Arkatarit për periudhen vjetore.**
- 2. Analiza e Kryetarit për gjendjen ndermjet dy tubimeve.**
- 3. Salla e kultures. Si, ku dhe kurë.**
- 4. Të ndryshme.**

Mledhjen e hapi z. Bajram Mehmeti i cili i pershendeti të gjith të pranoshmit në menyre vllazërore për kohen që gjeten me ardhë në këtë mledhje me këtë numër. Njiherit nji pershendetje të veqant jua drejtoj të rinjeve që morën pjesë. Më pas fjalën ja dha Arkatarit z. Muhamet Botushes.

Muhamet Botusha. Në konton e Shoqates për momentin kemi 6401.40 fr duke mos llogaritur shumën prej 1000 fr të ciklat i ka dhan në menyre vullnetare Arif Botusha para dy ditësh, (të cilën e falemenderuan të gjithë). Antarsija nuk është realja e asj sa jan bashkëvendasë që jetojnë në Zvicer. Nuk e di arsyt se pse nuk kyqen të gjithë. Deri me tani kan paguar vetem 16 vetë për vitin 2013, gjersa për vitin 2014 vetem 4 vetë. Dobtë. Kan dalë nga kontoja e shoqatës vetem 320 Fr. për pagesën e Faqes së internetit www.botusha.li. Ju lus që të gjithve që të kontriboni në rrethin e juaj Familjar që sam ë shum të kyqen në shoqatë.

Për pikën e dytë të rendit të ditës , fjalën e muar z. Bajram Mehmeti. Në fillim ceku Bajrami se në mbledhjen e fundit u kërkua që të bëhet nji Kërkesë Kryetares së KK të Gjakovës, z. Mimoza Kusari-Lila për zgjerimin e Urës mbi Gushë, në Hyrje të Fshatit. Kërkesa është perpilua e cila u lexu e tëra dhe njëzërit u aprovua.

Kryesia e Fshatit Botushë
Komuna e Gjakovës
Republika e Kosovës
17.05.2014

Botushë, më

Gjakovës
Lila

Për Kryetaren e Komunës së
Zonjën Mimoza Kusari-

Gjakovë –Kosovë

Lënda: **Kërkesë**

E nderuara Zonja Kryetare,

Në qytetarët e fshatit Botushë, komuna e Gjakovës, ju drejtohem me kërkesë për ndërtimin e urës së fshatit mbi lumin Gusha.

Arsyetim

Në hyrje të fshatit tonë mbi lumin Gusha, pas luftës së fundit, me ndihmën e një organizate

zvicerane është ndërtuar ura emergjente njëkahëshe. Me ndërtimin e kësaj ure sadokudo u bë një zgjedhje e përkohëshme dhe ne falenderuam shtetin zviceran për ndihmen e dhënë dhe se edhe sot i jemi mirënjohës atij shteti. Pasi që pas lufte, ajo periudhë ishte emergjente, ne nuk kishim mundësi të bënim diçka më të madhe për zgjerimin e asaj ure sepse rrethanat ishin të tilla. Siq e dini edhe ju vet, fshati ynë është një ndër fshatrat më të mëdhenjë të komunes së Gjakovës. Pasiqë bëhet fjalë për uren kryesore të fshatit, ne kërkojmë nga ju, Zonjë e nderuar, që të ndermerrni masa për ndërtimin e urës së re respektivisht zgjerimin e urës ekzistuese me mundësi kalimi dykahje. Ju bëjmë me dije se për shkak të kalimit një kahorë të urës, shpesh në hyrje të urës kanë ndodhur aksidente sidomos gjatë shëndrrimit të një automjeti dhe bagëti. Kërkesa jonë, në cilësinë e kontribuesëve të rregullt të tatimeve shtetërore, është reale, lehtësisht e realizueshme dhe arsyeton realizimin e saj me avansimin e zhvillimit ekonomik të fshatit dhe arsytet tjera historike që lidhen me fshatin dhe rrethinat e tij. Ju lusim, që kërkesa jonë të trajtohet si kërkesë prioritare.

Në këtë pritje dhe duke ju falenderuar për përpjekjet tuaja në realizimin e kësaj kërkesë, ne ju lusim të pranoni, Zonjë e nderuar, përsëritjet tona më të sinqerta.

Për Kryesinë e fshatit

U tha që kërkesa do të dërgohet në komunë dhe të dorzohet në menyrë Protekulare. Më pas Bajrami ceku nevojën që fshati ka për një Autocistern për raste emergjente në raste zjarresh, ku kohëve të fundit janë shpeshuar shumë në fshat. Bajrami tha se është në kontakt me një person që mirret me keto punë dhe posa të gjen një të tillë që na konvenon ne, do e blejmë. Për Shtëpinë e Kulturës, Bajrami tha se do filloim nga e para. Do bëjmë kërkesën për lejendërtim e pasi ta marrim lejen do bëjmë një plan ideorë e pastaj të filloim me projektin ashtu siq e parashohin rregullat.

Më pas Bajrami ja dha fjalën secilit nga të pranishmit. -

Asllan Salihu- Pajtohem me Bajramin. Toka e cekur për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës nuk i takon askujtë dhe se është pronë publike kështu që nuk kemi qka të kërkojmë leje prej ndokujtë. Askush se ka mbi vehte.

Islam Sadiki. Propozoi që para se të ndërtohet Shtëpia e Kulturës të sqarohet me shkrim prona ku do të ndërtohet që mos të na lindin probleme pastaj. Nëse kemi ndermend që të blejmë një Autocistern, është e udhës që depon ta ndërtojmë me të njëjtin plan pran Shtëpisë së Kulturës.

Lulzim Avdyli. Për mua gjeja primare është ujit i pijes i cili na mungon. Jam i mendimit që të investojmë në këtë drejtim dhe ta rrisim kapacitetin e ujit. Mendimi i im është se Shtëpia e Kulturës për momentin është Luks. Propozoi që të investohet dhe të ndihmohen edhe Varrezat e tjera të Urjelit e jo vetëm Varrezat e Mdhaja.

Arben Himaj. Ne kemi formë shoqat humanitare të ndihmojmë bashkëvendasit tonë me gjendje të vështir ekonomike. Për një Shtëpi të Kulturës ashtu siq po kërkohet, për momentin nuk kemi kapacitet. Kërkoj që të gjindet një person në fshat i cili do të mirret me pastrimin e bores gjatë dimrit e pagesën ta bëjë shoqata.

Nehat Botusha. Jam shumë i pelqimit që të blihet Autocisterna, sepse vetë rasti i fundit ku zjarrfiksit nga Gjakova ju nevoiten 1:30 minuta për të ardhur në fshat e ata nga Juniku 45

minuta. Edhe për Shtëpi të Kultures jam i pelqimit që të ndertohet.

Enver Alija. Qka të bejmë për Botushën, është vendlindja e jonë dhe nuk është e tepërt. Qdo gjë është pozitive.

Ramë Botusha. Dua të di se sa vetë janë njoftuar për këtë Mbledhje. Propozoi qe secili bashkëvendas që punon në CH të njoftohet dhe të thirret për mledhje. Jam i pelqimit që të ndertohet Shtëpia e Kultures dhe të blihet Autocisterna. - Bajrami i muar verejtjet si të arsyshme dhe do të shqyrtohen.

Fahri Alija. Propozoi qe njoftimet të lajmerohen me kohë dhe me se paku 3 javë përpara. Qdo ndihm për fshat është e mirseardhur dhe ju përkrahu.

Muhamet Botusha. Për varrezat e mëdhe në Urjel jan dhanë 1500 Fr. Fahri Avdyli ka financu një vit faqen e Botushës. Jam munduar ne qdo menyrë të informoj secil nga bashkvendasit tonë për këtë mbledhje. Poashtu edhe shperndarjen e fletpagesave po rezultatet po mungojn. Ne sa jemi ketu edhe disa tjerë qe janë aktiv, por per momentin nuk jan ketu, mundemi ti dalim qdo aksioni. Faleminderim te veqant për Arif Botushën për 1000 fr ndihm si dhe 700 € për blerjen e shportave te berllugot te cilat jan shpernda në tër fshatin.

Bedrush Mehmeti. Pershendet të gjith te pranishmit. Pajtohet për ndertimin e Objektit dhe blerjen e Autocisternes.

Adnan Avdyli. Pajtohet me parafolsit dhe kërkon qe ftesat për mbledhje të organizohen më mirë dhe me kohë.

Naim Zajmi. Qka të vendosni për investime në fshat do ta përkrahi dhe qdo vendim do ta zbatoj. **Sejd Musa.** Pajtohet me parafolsit.

Tahir Nimoni. Pajtohet me parafolsit.

Fahri Avdyli. Për Gelenderat e urës së Tolaj ishte mir qe vetë Lagjësja e Tolajve te kontriboj. Kan një numer të madh bashkvendasve që jetojn jashtë. Propozoi që së pari të grumbulloim mjetet e pastaj te nisemi me projekte konkrete. Pagesa e Anëtarisë le të mbeten në ndergjegjen e secilit. I përkrahi propozimet dhe do të kontriboj.

Baton Halilaj. Unë propozoi qe te nisem nga gjërat primare. Per mua primare është uij i pijes. Te kontribojm në rritjen e kapacitetit të uijt dhe propozoi që të meremetohet Xhamija e Fshatit. Nese fillon pastrimi i Gushës, unë një njeri dhe traktorin gjat tër dites do ta ve në dispozicion. - **Tahir Mehmeti.** Jemi shoqat Humanitare dhe ashtu te trajtohem. Askend nuk mundem ta obligojm për të berë pagesen. Për mua Shtëpia e Kultures është primare. Unë jetoj në Gakovë por zemra dhe shpirti me rrahë për Botushën. Mos të shtyhem për cikrrime. Unë me Arif Botushën do e ndetojm Shtëpin e Kultures, po deshëm. Edhe për Autocistern është propozim i qelluar dhe e përkrahu.

Arif Botusha. Pajtohet me propozimet e mëparshme. Propozoi që të pastrohet Gusha e tëra nga Livadhi i Hisenit e deri në Goraqë, pasi qe ka fillue grumbullimi i mbeturinave në menyrë të duhur. Të bisedohet me pronarin e Gurëthysit për pastrimin e uijt sepse me larjen e zhavorit, po na njolloset e tër Gusha dhe se me ata uij ne ujitim fushen dhe kopshtet tona, Ti kerkohet që ti ven filterat apo ta gjenë një zgjidhje. Keshtu është shumë keq. Jam i pelqimit për ndertimin e Sallës dhe blerjes së Autocisternes.

Islam Sadiki. Mur fjalën edhe njiher dhe kërkoj nga të pranishmit se nese dikush bie ne kontakt me ndonji firm qe punon me Hidrantë, ti blejm 5 copë e ti montojm në fshat në vendet kyqe për raste emergjente. Poashtu qe te intersohemi ti blejm gypat e zjarrfikseve që të na sherbejn deri sa të blehet Autocisterna.

Mbledhja përfundoj në frymen vëllazërore me një darkë të përbashkët.

Foto nga Tubimi









